

Dita Ndërkombëtare e Ujit

**10 rekomandimet që Kosova mund t'i implementojë për shfrytëzim më
racional të këtij burimi**

Hyrje

Me rritjen e popullsisë globale, po rritet edhe presioni në burimet ujore. Ky presion i ushtruar manifestohet me ndikime negative në mirëqenien sociale dhe ekonomike, por gjithashtu kërcënon edhe sigurinë kombëtare. Mungesa e ujit mund të shpie në destabilizim të vendit, rritje të numrit të shpërnguljeve, si dhe mungesë të prodhimit të produkteve bujqësore. E kjo e fundit për një vend si Kosova që mbështetet fuqishëm në sektorin bujqësor do të kishte pasoja edhe më të rënda në shoqëri, e gjithashtu edhe në zhvillimin ekonomik të vendit. Problemet kryesore me burimet ujore janë mungesa e tij, kontaminimi i ujërave nëntokësore, ndotja e ujërave sipërfaqësore, menaxhimi jo i mirë etj.

Ashtu si edhe ajri dhe pyjet, burimet ujore nuk janë në gjendjen më të mirë të tyre në Kosovë. Në mënyrë që gjendja e tyre aktuale të përmirësohet duhet të ketë bashkëpunim ndërinstitucional dhe gatishmëri për të përfshirë në agjendat e tyre zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor. Më poshtë janë listuar 10 masat që këto institucione mund t'i ndër marrin në mënyrë që të lehtësohen ndikimet negative të ushtruara në burimet ujore.

1. Përafrimi i legjislacionit me Acquis të BE-së dhe implementimi i plotë i tij

Kosova duhet të prioritozohet zbatimin e legjislacionit evropian me theks të veçantë Direktivës 2000/60/EC mbi Kornizën Legjislative të BE-së për Ujërat. Kjo kornizë legjislative bashkë Direktivën 2006/118/EC mbi Ujërat Nëntokësorë ofrojnë një bazë të mirë të planifikimit dhe implementimit të politikave për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe ruajtjen e resurseve ujore. Përveç përafrimit të legjislacionit, përpjekja më e madhe duhet të bëhet në zbatimin e tij.

2. Bashkëpunim ndërinstitucional dhe ndarja e përgjegjësi ndërmjet tyre

Ujërat dhe resurset ujore janë pasuri kombëtare dhe mbrojtja e tyre është përgjegjësi kolektive e institucioneve të Kosovës. Bashkëpunimi ndërinstitucional është i domosdoshëm për ruajtjen e burimeve ujore në Kosovë. Për shembull, aktivitetet minerare janë ndër ndotësit më të mëdhenj të lumenjve dhe ujërave nëntokësor të Kosovës. Institucionet duhet të bashkërendojnë në evidentimin dhe mirëmbajtjen e resurseve ujore, në mbrojtjen e tyre dhe në krijimin e mekanizmave për përdorim më racional të tij. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të koordinojë aktivitetet në mes të nivelit qendror, komunave dhe agjencive të tjera shtetërore.

3. Monitorimi periodik i gjendjes së resurseve ujore

Monitorimi i vazhdueshëm, i rregullt dhe i plotë i resurseve ujore dhe publikimi i statistikave të rregullta të sektorit. Mirëmbajtja e të dhënave të rregullta mbi gjendjen e ujërave në Kosovë është e domosdoshme për të pasur planifikim më të mirë të politikave, për informim publik dhe për të ditur zonat më të rrezikuara për intervenim. Mungesa e të dhënave do të thotë mungesë vetëdijësi mbi gjendjen e lumenjve, pellgjeve ujore dhe ujërave nëntokësore në Kosovë. Institucionet e mbrojtjes së mjedisit dhe të zhvillimit ekonomik duhet të publikojnë të dhëna të rregullta dhe të etiketojnë akterët përgjegjës për të vepruar.

4. Monitorimi i Ndërmarrjeve Publike (NPve) të sektorit të ujërave

Ndërmarrjet publike përgjegjëse për sigurimin e furnizimit me ujë duhet të sigurohen se qytetarët marrin shërbime cilësore me kosto të përballueshme dhe efikasitet të lartë të operimit. Pothuaj gjysma e ujit sot humbet në rrjetë të vjetruar e pa investime konkrete. Mungesa e menaxhimit ka bërë që kompanitë e ujësjellësit të shkelin të drejtat konsumatore me faturim paushall e furnizim jo të rregullt. 40% e ujit të prodhuar në fabrikën e Ujësllësit Rajonal në Mitrovicë nuk faturohet në komunat e veriut dhe ekzistojnë probleme të mëdha të politizimit të bordeve të këtyre ndërmarrjeve dhe keqmenaxhimit të parave publike.

5. Rritja e Kapaciteteve të Burimeve Njerëzore dhe Financiare të Institucioneve të Sektorit të Ujërave

Kosova nuk ka kuadro të mjaftueshme të ekspertëve të menaxhimit të burimeve ujore, të trajtimit të ujit dhe të politikave urbane në fushën e menaxhimit të ujërave. Përmes bashkëpunimit më të mirë të institucioneve përgjegjëse duhet bërë përpjekje që të ndihmohet përgatitja e kuadrove brenda ose jashtë vendit në këto fusha. Në të njëjtën kohë, përmes komunave, duhen inkurajuar dhe mbështetur organizatat lokale që kanë për qëllim mbrojtjen e ujërave dhe të investohet në rritjen e kapaciteteve të tyre.

6. Financimi dhe Zhvillimi i Studimeve për Resurset Ujore në Kosovë

Shoqëria kosovare ka nevojë të vazhdueshme për përgatitje të studimeve kualitative dhe kredibile të cilat elaborojnë tema të qëndrueshmërisë mjedisore. Në rastin konkret të resurseve ujore është e nevojshme të diskutohet dhe të ngritet vetëdijesimi tek komunitete për rëndësinë e lumenjve dhe mirëmbajtjen e tyre. Gjithashtu duhet theksuar pasojat që vijnë nga ndotja e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore. Prandaj, një ndër masat e preferueshme për mbrojtjen e resurseve ujore dhe që në të njëjtën kohë ka rëndësi të madhe është financimi dhe zhvillimi i këtyre studimeve mbi zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor. Komuniteti i hulumtuesve duhet nxitur në mënyrë që me analizat e tyre të identifikojnë problemet dominuese në sektorin e ujërave dhe promovojnë praktikën më të mirë të mundshme për zgjidhjen e problemeve mjedisore.

7. Menaxhim më efikas i lumenjve nga ndotjet industriale

Lumenjtë e Kosovës nuk janë në gjendjen më të mirë të mundshme. Shumicës prej tyre u duhet rehabilituar shtrati ose duhet pastruar nga mbeturinat komunale si dhe atyre industriale. E këto aktivitete përcillen me kosto të larta që duhet paraparë gjatë procesit të ndarjes të buxhetit shtetëror. Përpos që duhet rehabilituar lumenjtë e ndotur, ata duhet edhe të mirëmbahen. Mbetjet industriale, si p.sh. ato që vijnë nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK-u), janë kontaminuese për rrjedhat ujore. Pasojat e ndotjes së këtyre ujërave shkon zinxhir prej dëmtimit të ekosistemit dhe biodiversitetit të tij e deri tek sëmundjet e ndryshme që kërcënojnë shëndetin publik, dhe së fundmi por jo më pak e rëndësishme dëmtimi i vlerave mjedisore. Menaxhimi joefikas i lumenjve cenon fuqishëm edhe faunën e lumenjve të cilët kanë rol kyç në mbajtjen e balancit të zinxhirit të jetës.

8. Identifikimi i zonave të rrezikuara nga përmbytjet dhe zhvillimi i Planit Kombëtar për parandalim

Problem tjetër me të cilin sektori i ujërave është i shoqëruar është mundësia nga përmbytja e disa zonave. Këto zona të rrezikuara nga përmbytjet duhet identifikuar me kohë dhe të mirren masa për raste emergjente. Për këtë është e nevojshme hartimi i një Plani Kombëtar për parandalimin e dëmtimit të këtyre zonave të cenueshme. Ky plan kombëtar duhet të përmbajë udhëzime rreth parandalimit, përgatitjes, përgjigjes dhe rimëkëmbjes në rast të përmbytjes nga ujërat. Një pjesë e rëndësishme e këtyre planeve është edhe trajnimi i një personeli të cilët aplikojnë këto udhëzime dhe ndërmarrin hapa të menjëhershëm atëherë kur duhet. Gjithashtu, këto plane kombëtare për parandalimin e përmbytjeve duhet testuar dhe ushtruar nga ky personel.

9. Implementimi i gjobave dhe ‘Parimit Ndotësi Pagan’

Në rast të ndotjes së resurseve ujore, qofshin ato nëntokësore apo sipërfaqësore, ndotësi është vet përgjegjës për dëmin e shkaktuar në mjedis. Përpos që dëmi i shkaktuar është i kushtueshëm, edhe kostoja e pastrimit është mjaftë e lartë. Me fjalë të tjera, ekosistemi i dëmtuar nuk rehabilitohet shpejt dhe gjeneratat e ardhshme nuk do të mundën të gëzojnë plotësisht përparësitë e kësaj zone të mjedisit. Ligjet mbi mjedisin parashohin gjobat dhe ‘parimin ndotësi pagan’, sidoqoftë ato nuk janë të implementueshme në Kosovë. Kjo edhe për shkak të mungesës së burimeve njerëzore nëpër inspektoratet dhe mungesa e njëjësive funksionale nëpër komuna që merren me çështjet mjedisore. Prandaj, duhet rritur kapacitetet e inspektorateve të cilët ligjërisht janë kompetent në aplikimin e gjobave ndaj ndotësve. Të hyrat nga këto gjoba duhen trajtuar si të dedikuara për investime në pastrimin e resurseve ujore të ndotura dhe investime të tjera në këtë sektor.

10. Të vendosen objektiva specifike mjedisore në lidhje me ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore

Qëllimi i këtyre objektivave specifike mjedisore për resurset ujore është përcaktimi i drejtimit të ndryshimeve që duhet të ndodhin në komunitete drejt krijimit të një mjedisi të qëndrueshëm. Kjo nuk do të sillte përfitime vetëm për gjeneratën e tashme, por edhe për gjeneratat e ardhshme. Për shkak që impaktet negative të degradimit të mjedisit nuk kanë vetëm efekt lokal, por edhe regional dhe ndërkombëtar, objektivat do të ndihmonin në arritjen e një ambienti të pastër dhe të kualitetit të dëshirueshëm. Objektivat në formë të caceve janë edhe indikatorë të progresit të cilët do të vlerësonin mjedisin, respektivisht në këtë rast resurset ujore, në baza mujore dhe vjetore.